

## KONTRATË SHITBLERJE AKSIONESH

Sot më datë 23.12.2020, lidhet kjo kontratë shitblerje aksionesh (“Kontrata”) midis palëve të mëposhtme

- **1. Z. Mati Pepa**, Shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal G30525257W; në cilësinë e Aksionerit të shoqërisë “EuroBroker” SH.A., (më poshtë referuar si “Shoqëria”), i cili aktualisht zotëron në Shoqëri 1050 (njëmijë e pesëdhjetë) aksione, me vlerë nominale ALL, 1,050,000.00 (një milion e pesëdhjetë mijë Lekë)
- **2. Znj. Nereida Bujupi**, shtetase Shqiptare, lindur në Bajram Curri, më 11.05.1993, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal J35511061E; në cilësinë e Aksioneres të Shoqërisë, e cila aktualisht zotëron në Shoqëri 700 (shtatëqind) aksione me vlerë nominale ALL 700,000.00 (shtatëqind mijë Lekë)  
(bashkërisht në vijim, referuar si “Shitësit”)
- **Z. Altin Sinani**, shtetas shqiptar, lindur në Librazhd, më 2.03.1984, mbajtës i letërnjoftimi me nr. personal I40302027J, në cilësinë e Aksionerit të Shoqërisë, i cili aktualisht zotëron në Shoqëri 1400 aksione me vlerë nominale ALL 1,400,000.00 (një milion e katërqind mijë Lekë), (në vijim referuar si “Blerësi”);

Shitësit dhe Blerësi këtu e në vijim referohen, individualisht si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët”.

### MEQENËSE:


- Shitësit dëshirojnë të transferojnë një pjesë të aksioneve, përkatësisht:  
Mati Pepa dëshiron të transferojë 210 (dyqind e dhjetë) aksione që përbëjnë 6% (gjashtë përqind) të kapitalit të Shoqërisë tek Blerësi; dhe  
Nereida Bujupi, dëshiron të transferojë 175 aksione që përbëjnë 5% (pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë; tek Blerësi;
- Blerësi dakordëson me blerjen e aksioneve sipas raportit dhe përqindjes së lartpërmendur dhe dispozitave të kësaj Kontrate;
- Palët kanë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat e kërkuar nga Statuti për transferimin e aksioneve;

**PËR SA MË SIPËR**, duke marrë në konsiderate miratimet reciproke të shprehura këtu, Palët bien dakord si më poshtë:

### Neni 1

#### Objekti

- 1.1 Sipas kushteve dhe parashikimeve të kësaj Kontrate, Shitësit transferojnë nëpërmjet shitjes në emër të Blerësit, aksionet e zotëruar prej tyre në Shoqëri si vijon:
  - 1.1.1 Z. Mati Pepa transferon 210 (dyqind e dhjetë) aksione që përbëjnë 6% (gjashtë përqind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe





- 1.1.2 Znj. Nereida Bujupi, transferon 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë aksione që përbëjnë 5% (pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;  
dhe Blerësi i ble këto Aksione nga Shitësit, sipas çmimit të shitjes të parashikuar në nenin 2 më poshtë.
- 1.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi përfiton titullin e pronësisë dhe bëhet zotërues me të drejta të plota i 385 aksioneve me vlerë nominale prej 385,000.00 (treqind e tetëdhjetë e pesë mijë Lekë), duke zotëruar në këtë mënyrë një total prej 1785 aksione me vlerë nominale prej ALL 1,785,000.00 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë Lekë), të cilat përfaqësojnë 51% të kapitalit të Shoqërisë.

## Neni 2

### Çmimi i Shitjes

- 2.1 Çmimi i shitjes së aksioneve përfaqëson vlerën e rënë dakord mes Palëve, saktësisht vlerën nominale të aksioneve të zotëruara nga Shitësit në Shoqëri, përkatësisht të barabartë me ALL 210,000.00 (dyqind e dhjetë mijë lekë) dhe ALL 175,000.00 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë Lekë), pra në një vlerë totale prej ALL 385,000.00 (treqind e tetëdhjetë e pesë mijë Lekë - në vijim referuar si “Çmimi i Shitjes”), të pagueshme siç përcaktohet në pikën 2.2 të kësaj Kontrate.
- 2.2 Palët pranojnë që Çmimi i Shitjes të paguhet plotësisht, menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, me transfertë bankare nga llogaria bankare e Blerësit në llogarinë bankare të Shitësve.
- 2.3 Me përfundimin e këtij transaksioni, Blerësi zotëron 1785 aksione me vlerë nominale prej ALL 1,785,000.00 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë Lekë), të cilat përfaqësojnë 51% të kapitalit të Shoqërisë.

## Neni 3

### Deklarime dhe garanci

- 3.1 Shitësit deklarojnë dhe garantojnë Blerësin si vijon:
- Shitësit janë pronarë të ligjshëm të aksioneve, objekt i kësaj Kontrate.
  - Shitësit zotërojnë Aksionet të lira nga çdo peng, barrë siguruese, hipotekë, pengesë, pretendime të tretëve, kufizime, si dhe çdo masë tjetër sigurie apo ligjore;
  - Shitësit kanë marrë të gjithë autorizimet e nevojshme për të lidhur këtë Kontratë dhe se i kanë të gjithë tagrat për të nënshkruar këtë Kontratë.
- 3.2 Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin si vijon:
- Ka të gjithë aftësitë juridike për të nënshkruar këtë Kontratë dhe se nuk ka asnjë pengesë ligjore që do të cenonte aftësinë e tij për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë;
  - Do të kryejë pagesën e Çmimit të Shitjes, në përputhje me nenin 2.2 më sipër.

## Neni 4

### Ligji i Zbatueshëm

Kjo Kontratë, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin për Palët, do interpretohen dhe zbatohen në përputhje me legjislacionin shqiptar.



## Neni 6

### Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 6.1 Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që mund të lindë ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin, kryerjen, ekzekutimin, shkeljen, ndërprerjen dhe zbatimin e kësaj Kontrate, Palët do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për t'i zgjidhur ato në mënyrë miqësore.
- 6.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet palëve lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, të cilat nuk mund të zgjidhen në mënyrë miqësore, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## Neni 7

### Të ndryshme

- 7.1 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve lidhur me parashikimet në të. Çdo parashikim i kësaj Kontrate mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga Palët e kësaj Kontrate.
- 7.2 Kjo Kontratë hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

## PALËT

SHITËSIT

MATI PEPA

NEREIDA BUJUPI

*Mati Pepa*  
*Nereida Bujupi*

BLERËSI

ALTIN SINANI

*Altin Sinani*